

Përfitime plotësuese (EL) për sigurimin për pleqërinë dhe për të pasjetuarit AHV dhe për sigurimin për invaliditet IV Ergänzungsleistungen (EL) zur AHV und IV

Çfarë janë përfitime plotësuese?

Përfitimet plotësuese janë një pjesë përbërëse e rëndësishme e sigurimeve shoqërore në Zvicër. Nëse janë plotësuar kushtet ligjore, ekziston një pretendim ligjor — ashtu si edhe për pensionin e AHV-së ose pensionin invalidor IV (AHV- oder IV-Rente).

Kush ka të drejtë për përfitime plotësuese?

Të drejtë për përfitime plotësuese kanë marrëset dhe marrësit prej përfitimeve të AHV-së ose IV-së, pensioni i të cilëve është nën minimumin social të ekzistencës.

Minimumi social i ekzistencës përcaktohet nga rregulla të ndryshëm ligjorë të llogaritjes. Kush dëshiron të dijë, nëse ekziston e drejta për përfitime plotësuese, mund të përdorë këtë rregull të përgjithshëm për buxhetin mujor:

Të gjithë të ardhurat
- premiet për arkën shëndetësore
- qira

= Të ardhurat neto
=====

Nëse të ardhurat në rast të personave që rrinë me vete janë nën 1'634 franga dhe në rast të çifteve bashkëshortore nën 2'451 franga në muaj, rekomandohet që të sqarohet një pretendim për përfitimet plotësuese. Në rast të familjeve me fëmijë shumë e përmendura më lart ngrihen me 285 - 855 franga për fëmijë.

Nëse dikush jeton në një strehë, atëherë vlejné kriteret e ndryshme. Filiali i AHV-së i qytetit Bernë (AHV-Zweigstelle der Stadt Bern) me kënaqësi jep informacione për këtë.

Cilin rol luan pasuria?

Për vitin 2021 është futur një kufi maksimal i pasurisë. Individët që posedojnë më shumë se 100'000 franga, nuk kanë asnjë pretendim për përfitime shtesë. Për çifte bashkëshortore pragu është tek 200'000 franga.

Të ardhurat (p.sh. interesat nga llogaria e kursimeve) nga e gjithë pasuria u shtohet të ardhurave të tjera.

Nga pasuria personat që rrinë me vete mund të zbresin 30'000 franga dhe çifte bashkëshortore 50'000 franga. Në rast të familjeve shumëat e përjashtimit të pasurisë ngrihen me 15'000 franga për fëmijë. Nga shuma e mbetur merren, si rregull, 10%. Në kuadrin e llogaritjes së EI-it (përfitimeve shtesë) kjo shumë trajtohet si një e ardhur shtesë (për buxhetin mujor 1/12 nga kjo).

Pasuri të paluajtshme, në të cilat banoni vetë, i shtohen pasurisë tjetër vetëm, nëse vlera e tyre (zyrtare) i tejkalon 112'500 franga.

A duhet të kthehen përfitimet plotësuese?

Pas hyrjes në fuqi të revizionit të EI-it që nga viti 2021 përfitimet plotësuese, të cilat një person i ka marrë gjatë dhjetë viteve të fundit para vdekjes së tij, duhet të kthehen nga trashëgimia e tij. Në rast të çifteve bashkëshortore kthimi duhet të bëhet vetëm pas vdekjes së bashkëshortit të dytë. Për trashëgiminë jepet një shumë përjashtimi prej 40'000 frangave.

Kush i pranon kërkesat për EL?

Filiali i AHV-së i vendbanimit tuaj i pranon kërkesat për EL. Në qytetin Bernë filiali i AHV-së i përket seksionit për të moshuar dhe sigurime (Alters- und Versicherungsamt).

Kush u përgjigjet pyetjeve të tjera?

Pensionistet dhe pensionistët që jetojnë në qytetin Bernë, mund t'i drejtohen filialit të AHV-së së qytetit Bernë. Nëpunëset dhe nëpunësit me kënaqësi japin informacione në rast të pyetjeve për përfitimet plotësuese dhe ofrojnë mbështetje për t'i realizuar pretendimet për përfitimet plotësuese.

AHV-Zweigstelle der Stadt Bern
Bundesgasse 33
3011 Bernë

Tel. 031 321 66 89
Mail: ava@bern.ch

A dëshironi të mësoni më shumë për përfitimet plotësuese?

Filiali i AHV-së i qytetit Bernë organizon rregullisht aktivitete informative. Pjesëmarrësit informohen mbi pikat më të rëndësishme të përfitimeve plotësuese dhe mësojnë, përveç kësaj, se çfarë shërbimesh ofron qyteti për fazën pas punës. Ka mjaft mundësi për të shtruar pyetje ose për të shfrytëzuar një këshillim të shkurtër.

Të dhënat janë publikuar nën: www.bern.ch/ava